



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:200370  
Datë: 23.08.2024  
Numri i dokumentit: 06082533

**C.nr.447/16**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtaren individuale Erolinda Uka Sadiku, në lëndën civilo juridike të paditësve H.F, Sh.M., J.M, A.M dhe A.M., të gjithë nga fshati Koshtovë - Komuna e Mitrovicës, të përfaqësuar sipas autorizimit nga avokatët S., M., dhe L., D., P., me seli në Prishtinë, rruga “ Luan Haradinaj” nr.32 h19/2, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ E.,” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material, vlera e objektit të kontestsit 1,004.500.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, publik, mori ndërsa me datën 23.08.2024 hartoi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditësve H.F, Sh.M., J.M, A.M dhe A.M., nga fshati ., Komuna e Mitrovicës, ashtu që **OBLIGOHET E** paditura Kompania e Sigurimeve “ E.,” për 80% të përgjegjësisë në emër të kompensimit të dëmit jo material, të kompensojë paditësit dhe atë

- Për paditësen H.F., në emër të dhimbjes shpirtërore për vdekjen e bashkëshortit shumë prej 12.000 euro me kamatë ligjore 8% nga data e marrjes së aktgjykimit 23.08.2024, deri në pagesën definitive.
- Për paditësen Sh., M., në emër të dhimbjes shpirtërore për vdekjen e djalit shumë prej 12.000 euro me kamatë ligjore 8% nga data e marrjes të aktgjykimit 23.08.2024, deri në pagesën definitive.
- Për paditësin J., M., në emër të dhimbjes shpirtërore për vdekjen e babait shumë prej 9.600 euro me kamatë ligjore 8% nga data e marrjes të aktgjykimit të 23.08.2024 deri në pagesën definitive.
- Për paditësen A., M., në emër të dhimbjes shpirtërore për vdekjen e babait shumë prej 9.600 euro me kamatë ligjore 8% nga data e marrjes të aktgjykimit të 23.08.2024 deri në pagesën definitive.
- Për paditësin A., M., në emër të dhimbjes shpirtërore për vdekjen e babait shumë prej 9.600 euro me kamatë ligjore 8% nga data e marrjes të aktgjykimit të 23.08.2024 e deri në pagesën definitive.

**II. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesë padia e paditëses H.F., ashtu që **OBLIGOHET** E paditura Kompania e Sigurimeve “ E.,” në emër të kompensimit të dëmit material për shpenzimet mjeksore dhe shpenzimet e varrimit t’ia kompensojë:

- Në emër të shpenzimeve mjekësore t’ia paguajë shumën prej 20,000 euro, me kamatë ligjore 8% nga data e parashtrimit të kërkesës për kompensim 18.11.2015, në afat prej 15 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- Në emër të kompensimit të dëmit material për shpenzimet e varrimit t’ia paguajë shumën 645.08 euro, me kamatë ligjore 8% nga data e parashtrimit të kërkesës për kompensim 18.11.2015, në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**III. REFUZOHET pjesërisht** si e pabazuar kërkesë padia e paditësve H.F, Sh.M., J.M, A.M dhe A.M., nga fshati ., Komuna e Mitrovicës, që të **OBLIGOHET** E paditura Kompania e Sigurimeve “ E.,” që për 80% të përgjegjësisë në emër të kompensimit të dëmit jo material përtej pjesës së aprovuar si në pikën I të aktgjykimit dhe atë

- Për paditësen H.F., kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjes shpirtërore për vdekjen e bashkëshortit në shumë prej 221,000 euro.
- Për paditësen Sh. M., kompensimin e dëmit jomaterial në emër të dhimbjes shpirtërore për vdekjen e djalit në shumë prej 166,500 euro.
- Për paditësin J. M. kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjes shpirtërore për vdekjen e babait në shumë prej 189,200 euro.
- Për paditësen A. M. kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjes shpirtërore për vdekjen e babait në shumë prej 189,200 euro.
- Për paditësin A. M. kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjes shpirtërore për vdekjen e babait në shumë prej 189,200 euro.

**IV REFUZOHET pjesërisht** si e pabazuar kërkesa e paditësve H.F. përtej shumës së aprovuar si në pikën II me të cilën ka kërkuar që të **OBLIGOHET** E paditura Kompania e Sigurimeve “ .,” që në emër të kompensimit të dëmit material

- Për shpenzimet e varrimit e t’ia paguajë paditësve shumën prej 2,352.92 euro.
- Shpenzimet për rregullimin e varrit në shumë prej 1500 euro.

**V. REFUZOHET pjesërisht** si e pabazuar kërkesë padia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial të llogaritet kamata në nivel vjetor sa paguajnë bankat afariste për deponimet e qytetarëve pa destinim të caktuar duke filluar nga data e aksidentit deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh pas plotfuishmrisë së aktgjykimit.

**VI. OBLIGOHET** e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës tua paguajë paditësve shumën prej 4,260.4 euro, në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**VII. REFUZOHET pjesërisht** si e pabazuar kërkesa për shpenzimet e procedurës përtej pjesës së aprovuar si në pikën V të dispozitivit në shumë prej 300 euro.

## **A r s y e t i m**

Paditësit H.F, Sh.M., J.M, A.M dhe A.M., përmes të autorizuarëve të tyre, pranë kësaj gjykate me datën 08.08.2016, kanë parashtruar padinë ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “ E.,” për kompnesimin e dëmit material dhe jo material për shimbjet shpirtëore me vdekjen e N.Mt.

### **Juridiksioni I Gjykatës.**

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështjeje dhe bazuar në nenin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), por edhe me dispozitat e LMD, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur këtë çështje.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë nenin 17.2 të LPK-së: “Vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata”. Meqenëse ndodhemi përpara një kontesti me karakter civil që rrjedh nga marrëdhënia kontraktuale, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencën territoriale në bazë të nenit 47 të LPK-së: i cili përcakton se “47.1 Për gjykim në kontestet lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për demin, përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmtimit. 9 47.2 Në qoftë se dëmi është shkaktuar për shkak të vdekjes apo të lëndimit të rëndë trupor, kompetente është, përpos gjykatës nga paragrafi 1 i këtij neni, edhe gjykata në territorin e së cilës paditësi e ka vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e vet. 47.3 Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni do të aplikohen edhe në kontestet sipas padive civile kundër shoqërive të sigurimit për shpërblimin e dëmit personave të tretë në bazë të dispozitave mbi përgjegjësinë direkte të tyre.

Duke qenë se aksidenti 30.09.2015 ka ndodhur në fshatin K. rrugën Z. P. Mitrovicë, rezultoi se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje civile është kjo gjykatë.

Palët paditëse, legjitimohen t'i drejtohet gjykatës me këtë padi pasi që të njëjtët me të ndjerin N.M kanë qenë në bashkësi familjare dhe me vdekjen e të njëjtit paditësve i është shkaktuar dëm jo material,për dhimbjet shpirtëore prej nga rrjedhe dhe e drejta e tyre për të kërkuar kompensimin e dëmit nga e paditura.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të nenit 67 të LPK-së, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajftueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palët prezent në gjykim.

### **Pretendimet e palëve dërgjyqëse**

Të autorizuarit e paditësve fjalën përfundimtare e kanë dorëzuar me shkrim duke kërkuar që paditësja H.F., ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të lartë të paguajë shumën prej 100.000.00 euro, ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të mesëm ti paguajë shumën prej 70.000.00 euro, ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të ulët të paguajë shumën prej 30.000.00 euro, në emër të dëmit për shpezimet mjeksore të paguajë shuëmn prej 20,000.00 euro, në emër të shpenzimeve të varrmit të paguajë shumën prej 3,000 euro, në emër të rregullimit të varrit shumën prej 1.500.00 euro, gjithsej në shumë totale 224.500.00 euro.

Për paditësen Sh.M. në emër të ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të lartë shumën prej 100.000.00 euro, ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të mesëm ti paguajë shumën prej 50.000.00 euro, ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të ulët të pagujë shumën prej 30.000.00 euro, gjithsej shumën prej 180.000.00 euro.

Për pdaitësin J. M., ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të lartë shumën prej 100.000.00 euro, ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të mesëm ti prej 70.000.00 euro, ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të ulët të pagujë shumën prej 30.000.00 euro, gjithsej shumën prej 200.000.00 euro.

Për paditësen A. M. në emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të lartë shumën prej 100.000.00 euro, ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të mesëm ti prej 70.000.00 euro, ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të ulët të pagujë shumën prej 30.000.00 euro, gjithsej shumën prej 200.000.00 euro.

Për paditësin A. M. ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të lartë shumën prej 100.000.00 euro, ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të mesëm ti prej 70.000.00 euro, ne emër të dhimbjeve shpirtërore të intensitetit të ulët të pagujë shumën prej 30.000.00 euro, gjithsej shumën prej 200.000.00 euro.

Tutje në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim,paditësit kanë kërkuar aprovimin e kërkesë padisë sit ë bazuar si dhe kompneismine shpenzimeve të procedurës për përpilimine padisë shumën 650 euro, per tri seanca nga 845.00, për seancën e daës 02.06.2022 avoatëve ju takon shpërblimi 25% I shumës që I bie 215.25 euro, për padi dhe seanca shumën pej 3,396.5 euro dhe 800 euro në emër të ekspertizave.shumën prej 800.00 euro.

Përfaqësuesja e të paditurës, në fjalën përfundimtare deklaroi se mbesim në tërësi pranë deklarimeve dhe kundërshtimeve të deritanishme, tani më është konfirmuar fakti se përgjegjesinë në këtë aksident e ka edhe I ndejri N., M.,i I cili ka ndikuar ne rritjen e vëllimit të dëmit e që nga nga kjo mund të dalim në konkluzion se në qooftë se I nejjti në kohën e aksdentit do të kishte vozitur veturëne tij sipas kudizimeve rrugore atëherë I nejjti do të kishte lëndime dukshëm më të leheta dhe nuk do të vinte deri tek ndarja e tij nga jet. Andaj I kërkojmë gjykatës që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë duke refuzuar shumat tejet të larta dhe aspak në harmoni me dëmin real dhe ndarjen e përgjegjësisë të cilat janë kërkuar nga pala paditëse dhe duke refuzaur shumat mbi shumën e ofruar nga e paditura. Po ashtu sa I përket shpenzimeve procedural kekojmë që të njejtat të aprovohen duke u bazuar në suksesin e procedurës.

## **Provat e administruara**

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor administroi provat si në vijim: çertifikatën e vdekjes për N.Mn me nr.rendor 1889 lëshuar me datën 16.12.2015, Deklaratën e bashkësisë Familjare me numër rendor 11/11001/1 lëshuar me datë 17.12.2015, Certifikata e lindjes për H.F., J.M.,A.M., A.M, dhe Sh.I, Fletëvdekja me epikrizë me numër të amzës 341/15, Vërtetimi për vdekjen e N., M., lëshuar me datën 07.12.2015, Dokumentacioni mjekësor me nr 14388 I datës 30.09.2015 I Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë, Letra referuese e e trajtimit jashtë vendit e lëshuar nga QKUK me datë 30.09.2015, Dokumentacioni mjekësor me nr rendor 14388 I datës 30.09.2015 I Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë, Raport mjekësor I lëshuar nga QKUK me datë 30.09.2015 me numër rendor 36524, Kërkesa e datës 18.11.2015 drejtuar Kompanisë së Sigurimeve “ D.,” Kërkesa e datës 03.12.2015 drejtuar Bankës qendrore të Kosovë, Njoftimi I datës 15.05.2016 I Kompanisë E., Raporti mjekësor I QKUK-së me nr. 40603 datë 28.10.2015, Raporti mjekësor I QKUK-së me nr. 36529, Njoftimi nga Zyrapër Trajtim jashtë institucioneve publike, Dokumentacioni mjekësor për N.M I lëshuar nga klinika “A.,” “ S.,” prej datës 07.10.2015 deri me datën 09.10.2015, Vërtetimi I lëshuar nga klinika “ A.,” “ S.,” I datës 09.10.2015 dhe konstatimi për gjendjen mjekësore të pacientit N., M., me datën 14.10.2015, fatura me nr 134263 e datës 28.10.2015, Lista e Dëmve nga agjensioni “ sharr Expres” e datës 01.10.2015 në emër të Zahir Miftari, kupni fiskal I lëshuar nga NLB n=bank, Formulari me nr 00003862 2 faqe, 6 kupona fiskal të telefonisë, Raporti Mjekësor nga Departamenti I Radiologjisë së Klinkiës “a A.,” Raporti mjekësor I klinkiës Acibadem I datës 09.10.2015, Kostajoja e shpenzimeve mjekësore të lëshuara nga U.R., e datës 06.11.2015, Marrëveshja e kshuar nga “ E., „a car” Kuponi I lëshuar me datë 17.10.2015, Shpenzimet e lëshuara nga klinika A., me datë 17.10.2015 me numër 93234848 në shumë prej 19.600 euro, faturat e datave 01.10.2015, 06.10.2015, 17.10.2015, 18.10.2015, depozita bankare në Procredit Bank në shumë prej 350.00 euro, kopja e letërnjoftimit dhe patent shoferi për N., M., tri fotografi të N., M., të shtrirë në Spital, Raporti I lëshuar nga Spitali Gj., Pasaporta në emër H., dhe N., Konstatimi I mjekut Nickola Sikof lëshuar me datë me datë 14.10.2015, Fatura nr 134263 e datës 28.10.2015 lëshuar nga “ Istambul Mecinin”, Kupni fiskal nga klinika “ Istanbul Medicin” në shumë prej 1,650 mkd, faturat e lëshuara nga D.P.H. “ D.,” nr 117/15, 118/15, 119/15, 121/15, Raporti mjekësor I lëshuar nga Klinika “ A.,” dr., S.,-sakova, Recetat e barërave për datat 29,30.10.2015, 16.11.2015,17.11.2015, 18.11.2015,19.11.2015, 21.11.2015,23.11.2015, 24.11.2015, 26.11.2015, 27.11.2015, 29.11.2015, 30.11.2015, 01.12.2015, 02.12.2015, 03.12.2015, 04.12.2015, 06.12.2015, Ekspertiza e neuropsikitarit ., Raorti I aksidentit të Komunikacionit 30.09.2015, skica nga vendi I ngjarjes, kallximi penal I datës 30.09.2015, raporti I oficerit ., datë 22.10.2015, Kërkesa për Shperblimin e dëmëve jo material e datës 25 dhe 30.11.2015, Kërkesa e ndryshuar e datës 22.01.2016 drejtuar të paditurës “ E.,” Njoftimi I datës 19.05.2016 I të paditurës E., Ankesa e datës 20.05.2016 drejtuar të paditurës E., Kërkesa e datës 13.04.2016 drejtuar të paditurës E., ekspertizimi mjekoligjor I datës 30.11.2017, Ekspertiza e psikologut klinik ., e datës 21.07.2022, Ekspertiza e komunikacionit atë 31.01.2024.

## **Faktet**

Nga leximi i Raportit të Aksidentit të Komunikacionit 2015-BR-490 të datës 30.09.2015, kallximi penal I datës 30.09.2015, raporti I oficerit ., datë 22.10.2015, rezulton se 30.09.2015 rreth orës 19:40 në rrugën magjistrale të U., Z., P.,-M., fshatin K.,ë, Komuna e Mitrovicës,

lagjen C., ka ndodhur aksidenti deri sa automjeti pikap “V., ka qenë duke u kqyr nga rruga anësore në rrugën magjistrale Mitrovicë në mënyrë të pasigurt duke mos shikuar fare në rrugën magjistrale, posa del në rrugë nga drejtimi I Mitrovicës për në Z. P. ka qenë duke lëviuar vetura e tipit “ R.,” me me targa të regjistrimit 02-729-., ngjyrë vjollcë, e drejtuar nga N.M, I cili automjeitn e ka drejtuar me skadim të regjistrimit prej datës 29.09.2015, i cili në pamundësi që ti ikë aksidentit me pjesën e përparme të automjetit të vet e godet autojetin V., derën e anës së majtë ku nga goditja humb kontrollin, del jashtë rrugës dhe përplasat në derën e dyqanit “ G.,” lëndime trupore pëson drejtuese I automjetit dhe pasagjerët .

Nga leximi I kallzimit penal rezulton se ndaj R., H., është ngritur kallzimi penal lidhur me veprën penale rreziki I trafikut Publik nga neni 378.1 pika.,

Nga leximi i raporti të oficerit ., datë 22.10.2015, rezulton se pjesmarrës në aksidentin e shkaktuar me datën 20.09.2015 R., H., I cili në momentin e aksidentit po e automjetin pikap ransportues të tipit “.” ngjyrë të gjelbër me taraga 02-695-., pa patent shoferë dhe N., M., në momentin e aksidentit ka qenë duke drejtuar automjetin për trasnportimin e udhëtarëve Renault .,” me me targa të regjistrimit 02-729-AR, ngjyrë vjollcë.

Nga dokumentacioni mjekësor I lëshuar nga Spitali I Përgjithshëm emergjenca në Mitrovcië, numër 14388 I datës 30.09.2015 rezulton se N.,M., është pranuar rreth orës 20:00, arsyeja e ardhjes ka qenë fatkqesi komunikacioni, saturimin e ka pasur 99%, pulsi 80, lëvizshmëria 6 të folurit 5 , është transferuar në QKUK.

Nga shiqimi I pantënte shoferit rezulton fakti se N., M., në kohën kur ka ndodhur aksidenti ka pasur pantentë shoferin e kategorisë (b).

Nga leximi i dokumentacionit të Qendrës Klinike Universitare me nummër 36529, vërtetohet fakti se tani i ndjeri nga Emergjena në Mitrovicë është transferuar në QKUK me shenjat vitale si në vijim: saturimi 99%, pulsi 62, ta 116/67, sytë katër, lëvizshmëria 4 të folurit 5, I nejjti është kontrlluar nga ortopedi, neurokirurgu dhe krurgu abdominal.

Nga leximi i dokumnetacionit të Klinikës A., S., rezulton se N.M, I lindur me 22.05.1973 ishte sjellë në klinikë me datën 01.10.2015 pas gjashtë orëve të aksidentit nga I cili kishte pësuar lëndime trupore në klinikën “ Acibdem Sistina” ishte kryer ekzaminimi në pjesën cervikale të shtyllës kurrizore, zbulimi I gjendjes pas trajtimit trajtimit operativ nga C4 në Tx1, zbulimi I trashes së gishtit me karakteristika hipersinjale, johomogjene në sekuencën T 2, këto gjetje korespodojnë me përmbajtje hemorragjike në medullë pra hematomieli, ne lartësinë C1 dhe C2 medullë, zbulimi I hipersinjalit qëndror në sekuencën T2 që korresponon me edemën.

Nga leximi raportit mjeksor nga Departamenti I Radiologjisë në Klinkën A., S., rezulton se me datën 01.10.2015, N.,H., është ekzaminuar duke iu bërë CT e tërë trupit, me të gjeturat sin ë vijim: Sipas skanimeve të kokës parenikma e trurit të vogël, truri I vogë dhe pjesa e demonstrua e trungut të trurit nuk tregojnë ndonjë shenjë të dukshme të ndryshimeve të fokale, Sistemi ventricular dhe hapësira subraknoidale me gjerësi të regullt, mukocela ndiqet në sinusin maksilar të djathtë me përmasa 1 cm, zbulohen shenja jo bindëse të CT për ekzistencën e ndryshmeve të

reja traumatike në dritaren e skeletit , në prerjet e regjionit të qafës në nivelin C3/C4gjurmohe avulsioni, C3 me degjenrim vaku, ngushtim I shprehur në C5/C6 me degjenrim vakum C5 si dhe një fragmet të vogël nga me shumë mundësi një osteofit I mëparshëm me përmasa 5x7 mm në kanalin kurrizor në të djathtë, aorta në pjesën ashednte pak më e zgjeruar në përmasa deri në 4 cm, në prerjet e mëlqisë së barkut pas asnjë shenjë të ndryshimeve fokale.

Nga leximi i Konfirmimit të datës 09.10.2015 lëshuar nga Spitali A., S., vërtetihet fakti se N.M është shtruar me datën 01.10.2015 në departamentin e traumatologjisë dhe terapisë intensive dhe nga d. ., është gjetur në gjendje kritike..

Nga leximi I konstatimit të doktorit ., pranë Spitalit A., S., dhnë me datë 15.10.2015, rezulton se N., M., është 15 ditë në ICU në Spitalin Klinik A.,S., Shkup, ai është I vetëdijshëm, katërplegjik, është kryer trakeostomia, terapia : antibiotikë, ushqim enteral përmes tubit nazogastri, fizioterapia dhe aspirimi trakeobronikal kryhet gjatë gjithë ditës.

Nga leximi i dokumentit mjeksor lëshuar nga Spitali A., S., me datë 07.10.2015, nga doktori .,, rezulton se diagnoza për N., H., ka qenë G82 Tetraplegji e paspecifikuar, frakturë vert C5-C6, spondilolisteza vert C4-C5.

Nga leximi i dokumentit mjeksor lëshuar nga Spitali A., S., me datë 09.10.2015, nga radiologu dr. .,, rezulton se ndaj pacientit N., H., është vendosur fiksimi dhe stabilizimi I OSM në segmentin cervical të shtyllës kurrizore, set kanalesh endotrakeale, pozicioni i mirë I katetrit venoz qëndror, konsolidimi I parenkimës së mushkëriove, dypalësh më I shprehur në të majtë, efuzion pleural më I vogël në mënyrë bilaterale.

Nga leximi i dokumentit mjeksor lëshuar nga Spitali A., S., me datë 04.10.2015, nga doktoresha .,, rezulton se me datën 10.04.2015, ndaj pacientit N., H., është kryer rentegeni I mushkërive me gjetjet: konsolidimi bazal I djathtë, FK sinuset aderente, CVC është vendosur në të djathtë.

Nga leximi i dokumentit mjeksor lëshuar nga Spitali A., S., me datë 07.10.2015, nga doktori ., rezulton se me datën 07.10.2015, është kryer rentegeni i mushkrive me gjetjet si në vijim: komplet tubsi, gjendja pas trajtimit operative të pjesës së qafës së shtyllës kurrizore, djathtas në pjesët distale të mesme, zbulimi I një pjese të hijezuar të parenkimës së mushkërive e cila ka shumë ët ngjarë të korrespdojë me një zonë atelekatike, pneumotoraks I pjeshshëm nuk mund të përjashtohet, zemra e zmadhur në të majtë, fk sinuset me hije, efuzion I vogël plural në mënyrë bilaterale nuk mund të përjashtohet, vendosur fiksimi dhe stabilizimi I OSM në segmentin cervical të shyllës kurrizore, set kanalesh endotrakeale.

Nga leximi i dokumentit mjekësor lëshuar nga Spitali A., S., me datë 05.10.2015, nga doktori .,, rezulton se me datën 05.10.2015 ndaj N.,H., është kryer ekzaminimi në pjesën cervikale të shtyllës kurrizore në sekuencë standarde dhe rrafshnalta , në pjesën e qafës së medullës në nivelin C4 në Tx1 zbulimi i trashjes së gishtit, në të karaktersiatikat hipersnijale johomogjene në sekuencën T2 janë të dukshme, këto gjetje korrespodojnë me përmbajtje hemorragjike në

medullë, pra hematmieli, në lartësinë C1 dhe C2 në medullë, zbulimi I hipersinjalit qëndor në sekuençë T2 që korresponдон me edemën.

Nga leximi i konstatimit për gjendjen e pacientit N.M, sipas raportit të datës 14.10.2015, lëshaur nga doktori Dr..., rezulton se pacienti është 15 ditë në ICU, spitalin klinik A., S., në Shkup, ai është i vetëdijshëm, katërplegjike, në mënyrën e kontrolluar të vërtetimit mekanik, është kryer trakeostomia , terpaia që I është dhënë pacientit ka qenë antibiotikë, ushqim enteral, vitamin, furoseme, fizioterpaia dhe aspirimi trakebronikal kryhen gjatë gjithë ditës, për momentin ai është hemodinamikisht stabil.

Nga leximi i faturës me numër 291278183 të lëshaur me datë 17.10.2015 nga Klinika A., S., rezulton se shpenzimet totale e shpenzimeve mjeksore në këtë klinikë për paicentin N., M., është 1195600,87 denarë.

Nga leximi i faturës me numër 291278183/15, lëshuar me datë 17.10.2015, nga Klinika A.,S., në gjuhën angleze rezulton se trajtimi mjeksor për N., M., i lindur më 22.03.1973, në valutën euro është 19.600 euro.

Nga leximi i faturës së Medical I., nr. 134263 datës 28.10.2015 vërtetohet fakti se për shpenzimet lidhur me gjendjen shëndetësore të N., M., është paguar shumë në lartësi prej 150.00 euro.

Nga leximi i listës së dëmvë të agjesionit të Udhëtimit “ .,” vërtetohet fakti se depozitën e ka marrë Zahir Miftari në shumë prej 300 euro cash.

Nga leximi i formularit S.F.B rezulton se N.M nga QKUK në Prishtinë është dërguar në Klinikën A.,S., në Shkup, përmes Kompanisë S.F.B., me datën 01.10.2015 në ora 03:05, ndërsa nga transaksioni bankar në P., Bank vërtetohet fakti se kompanisë për bartjen e pacijentit N.Mt në emër të transportit i janë paguar 350.00 euro.

Nga leximi i kuponit me numër fiskal 600684931 rezulton se në emër të mbushjes elektronike janë paguar 10 euro.

Nga leximi i kuponit me numër fiskal 600689618 rezulton se në emër të mbushjes elektronike janë paguar 12 euro.

Nga leximi i kuponit me numër fiskal 600684931 rezulton se në emër të mbushjes elektronike janë paguar 10 euro.

Nga leximi i kuponit fiskal të datës 01.10.2015 rezulton se në emër të mbushjes elektronike janë paguar 40 B.

Nga leximi i kuponit fiskal të datës 06.10.2015 rezulton se në emër të mbushjes elektronike janë paguar 40 b.

Nga leximi i kuponit fiskal të datës 17.10.2015 rezulton se në emër të mbushjes elektronike janë paguar 2350.00

Nga leximi i faturës 117/15 të D.P.H “ D.,” datës 08.12.2015, rezulton se janë paguar 67.00 euro për 70 copë ushqim.



Nga leximi i faturës 118/15 të D.P.H “ D.,” datës 09.12.2015, rezulton se janë paguar 136.44 euro për 70 sasi ushqimi.

Nga leximi i faturës 119/15 të D.P.H “ D.,” datës 10.12.2015, rezulton se janë paguar 136.86 euro për 80 sasi ushqimi.

Nga leximi i faturës 120/15 të D.P.H “ D.,” datës 11.12.2015, rezulton se janë paguar 169.49 euro për 80 sasi ushqimi.

Nga leximi i faturës 121/15 të D.P.H “ D.,” datës 12.12.2015, rezulton se janë paguar 137.29 euro për 60 sasi ushqimi.

Nga leximi i kostove të trajtimit mjekësor në Spitalin Universitar A., rezulton se shpenzimet për mjekimin spitalor kushtojnë 50.000 euro, shpenzimet shtesë për pacientët ndërkombëtarë kushtojnë 370 euro, dhomat teke të mëdha tarifohen 165 euro duke përfshirë akomodimin e një personi shoqëruar nëse ka, dhoma e vogël teke 120 euro në shumë totale prej 4.950 euro, tarifat e mjekëve të lartë rreth 44.680 euro, qendra e rehabilitimit neurologjik 50.000 euro, plani i rrezikut 50.000 euro, shuma totale 200.000 euro, shuma prej 200.000 euro duhet papaguar para pranimit të parë .

Nga leximi i kostove të trajtimit mjekësor në Spitalin Universitar A., për N.Mn, rezulton se diagnoza mjekësor që shkakton trajtimin është tetrapareza posttraumatike, situata pas spondilodezës C5/C6, plani dhe procedurat e parashikuara të trajtimit: ekzaminimi klinik, kontrolli i përgjithshëm, ekzaminim mikrobiologjik, CT, nëse është e nevojshme kirurgjia e shpinës cervikale, kujdes intensiv, kohëzgjatje e trajtimit të pacientit 30 ditë, kohëzgjatje e pritshme e trajtimi në një qendër rehabilitimi neurologjik 2 muaj. Shërimi i tetraplegjisë nuk do të arrihet.

Nga leximi i Deklaratës për Bashkësinë Familjare, me numër serik F 10051920, rezulton se na bashkësinë familjare të N.Mt me nr personal 1004722112, i lindur më .., janë nëna Sh., M., e lindur më ..5, bashkëshortja H., M., e lindur më .., djali J., M., i lindur më .., vajza A., M., e lindur më .. dhe djali A., M., i lindur më ..

Nga leximi i letër referencës së lëshuar nga Qendra Klinike Univesitare e Kosovës, koliziumit prej tre mjekëve ortoped Mr.SC.Dr .., Dr., dhe MR.SCi.DR .., me datë 30.11.2015 rezulton se për N.M, është indikuar tretamnai operatin jashtë Kosovës, për shkak të natyrës së lëndimit dhe urgjencës së lartë dhe mungesës së kapaciteteve profesionale dhe materiale, intervenimi është kryer me datë 01.10.2015 në Spitalin Sistina A., në Shkup.

Nga leximi i Vërtetimit lëshuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës ( QKUK) me datë 07.12.2015, vërtetohet fakti se N.M ka vdekur më 07.12.2015, në Prishtinë, shkak i vdekjes ka qenë arresti cardiorespirator, gendja e cila e ka sjellë deri te shkaktari i drejtpërdrejtë i vdekjes ka qenë sT.post caraccident , Tetraplegia G82.5, Fracura vertebrae C5-medulla spinalis, haematomyelia, spondylolisthesis, vertebrae C4-C5, tracheostomia, Exitues letalis, vdekjen e të ndjerit N.M e kanë konstatuar Dr., dhe Dr. .,

Nga leximi i Vërtetimit Mjekësor për Vdekje me numër rendor 339, vërtetohet fakti se N.M ka vdekur në maternitet, me datën 07.12.2015, në ora 15;20 min, vdekja është e dhunshme, lloji i vdekjes së dhunshme është fatkeqësi në rrugë.

Nga leximi i certifikatës së vdekjes me numër serik V 10025209, me numër rendor 1889 rezulton se N.M me numër personal 1004722112, ka lindur me 22.05.1973 në Koshtovë, ndërsa ka vdekur me 07.12.2015 në Prishtinë.

Nga leximi i Fletëvdekjes me spikriz me nr të amzës 341/15 lëshuar nga Klinika universitare e Kosovës- Klinika e Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intenziv, nga ASS.DR.SCI., MD, Dr., dhe DR., dhe Dr., rezulton se i është bërë ekzaminimi klinik me rtg pulmo hijezim më i theksuar në baza, EKG: pa ndryshime patologjike, analiza laboratorike: Le=9.0...90, Er=2.98....2.27, HGB=9.5...7.0, Hct=26.5....19.0, Tr=151...78, Glikemia=5.6....11.1, Urea=4.83...13.8, Creatinina=62.1....89.8, prot.tot=53.9....45.1, ALb=32.6...24.6, ph=7.35...7.51, BE=4.9....0.3, Na=139...128, K=4.2..3.7, Ca=0.83...0.61, HCO3=27.6...25.4, HBSAG/HCV/HIV-negativ, se gjatë tërë kohës ka qenë me ventilim teknik, është trajtuar me kristaloide, antibiotik, H2 bllokator, antitrombotik, LMËH, barëra vazoaktive, ushqim parentereal dhe enteral, antihipertenzivtiv, Risperido, analgjetikë dhe terapi tjtër sipas nevojave ditore.

Nga komenti i Epikrizës është konstatuar se “ gjenjda e pacinetit tërë kohën e rëndë, ditët e fundit i pavetëdishëm, nuk reagon as në ngacmime të thella të dhimbjes, në frymarrje në ventilim mekanik, modi BIP AP, hemodinamikisht jo stabil. Me datë 07.12.2015 gjendja e përgjithshëm edhe më tutje përkeqësohet, hemodinamikisht jostabil, përkundërterapise me subsatnca vazoaktive bie në insuficiencë kardiorespiratore dhe përkundër masave intenzive reanimuese nuk arrihet të ftohet ritëm stabil kardiak dhe në ora 15.20 konstatohet exitus letalis”

Nga leximi i certifikatës së lindjes me numër serik L 10453514, rezulton se Sh., B., me nr personal .., ka lindur më .., në V., nga babai M., B., dhe nëna N., B.,.

Nga leximi i certifikatës së lindjes me numër serik L .., rezulton se A., M., me numër personal .., ka lindur më .., në .., nga babai N.M dhe nëna H., M.,.

Nga leximi i certifikatës së lindjes me numër serik L 1.,6 rezulton se A., M., me numër personal .., ka lindur më .., në Mitrovicë nga babai N.M dhe nëna H., M.,.

Nga leximi i certifikatës së lindjes me numër serik L .., rezulton se J., M., me numër personal .., ka lindur më .., në Mitrovicë nga babai N.M dhe nëna H., M.,.

Nga leximi i certifikatës së lindjes me numër serik L 10453..rezulton se H., F., me numër personal .., ka lindur më .., në .., nga babai M., F., dhe nëna F., F., K.,.

Nga leximi i letrës së aplikimit për vizë mjekësore në shtetin Gj., së datës .., vëretetiohet fakti se është aplikuar për vizë shëndetësore në shtetin e Gj., për pacientin N.M dhe shoqëruesen e tij H., M.,

Nga shiqimi i pasaportës së N.Mt rezulton se është lëshuar viza schengen me numër .., nga data .., deri me datën 2605.201.

Nga shiqimi i pasaportës së N., M., rezulton se është lëshuar viza schengen prej datës .., deri me datën 29.03.2016.

Nga shiqimi i pasaportës në emër të H., M., vëretteohet fakt se është lëshuar viza schengen nga data ., deri me datën 01.03.2016.

Nga shiqimi i tri fotografive të N.Mt, i njejt shihet se është i shtrirë në spital, sistem teknik të frymarrjes, në të cilat fotografi është dhënë mbishkrimi “ Një aksident i rëndë automobilistik dy muaj më parë dhe ai tashmë po lufton me jetën, në rrezik vdekje dhe duhet të trajtohet jashtë Kosovës por trajtimi kushton 200,000 euro në Spitalin Universitar të A.,t”, në këtë fotografi është dhënë emri i Sh.,\ M., dhe numëri i xhirllogarisë XK., së ..

Nga leximi i njoftimit të Kompanisë “ E.,” datës 19.05.2016, rezulton se “ Kompania E.,” për shpërblimin e dëmit të pësuar ka caktuar që të bëhet kompensimi në lartësi prej 35720.00euro, ne emër të përfaqësimit 215.00 euro në shumë totale në lartësei prej 35935.00 euro.

Nga leximi i raportit të ekspertizës së neuropsikiatrsë së punuar nga neuropsikiatri proff.ass.Dr..., rezulton se paditësja H.F., ka pësuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që ka zgjatur gjashtë muaj, dhimbje shpiërtore të intensitetit mesatar që ka zgjatur një vit, dhimbje shpirtëore e intensitetit të ulët është prezentë edhe sot e ksaj dite ritheksohet në përvjetore, ahengje familjare dhe festa religjioze.

Për paditësen Sh., M., sipas raportit mjekësor rezulton se ka pësuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që ka zgjatur gjashtë muaj, dhimbje shpiërtore të intensitetit mesatar që ka zgjatur një vit, dhimbje shpirtëore e intensitetit të ulët është prezentë edhe sot e ksaj dite ritheksohet në përvjetore, ahengje familjare dhe festa religjioze.

Për paditësin J., M., sipas raportit mjekësor rezulton se ka pësuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që ka zgjatur gjashtë muaj, dhimbje shpiërtore të intensitetit mesatar që ka zgjatur një vit, dhimbje shpirtëore e intensitetit të ulët është prezentë edhe sot e ksaj dite ritheksohet në përvjetore, ahengje familjare dhe festa religjioze.

Për paditësen A., M., sipas raportit mjekësor rezulton se e njëjta ka pësuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që ka zgjatur gjashtë muaj, dhimbje shpiërtore të intensitetit mesatar që ka zgjatur një vit, dhimbje shpirtëore e intensitetit të ulët është prezentë edhe sot e ksaj dite ritheksohet në përvjetore, ahengje familjare dhe festa religjioze.

Për paditësin A., M., sipas raportit mjekësor rezulton se ka pësuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë që ka zgjatur gjashtë muaj, dhimbje shpiërtore të intensitetit mesatar që ka zgjatur një vit, dhimbje shpirtëore e intensitetit të ulët është prezentë edhe sot e ksaj dite ritheksohet në përvjetore, ahengje familjare dhe festa religjioze.

Nga leximi i ekspertizës ë psikologut klinik A., M., rezulton për paditësen Sh., M., ka kaluar dhe po kalon në fazën e goditjes ku i kanë shkaktuar tmerr, hutim emocional, shkëputje nga çdo gjë që ndodh dhe anasjelltas, shpërthime të brendhshme mpirje mendore, pandjeshmëri, përceptime të zbeththa, humbje force, rraskapitje, mungesë oreksi, ku mund të vërehen disa ndryshime edhe në vetëdije, një ndjenjë e lehtë jo realiteti, ndjenjë e rritjes ë distancës emocionale nga të tjerët, pastaj fazëne depressionit ( vuajtje, çorganizim, malli, vetmia, tërheqja në vetvete dhe zhytja e thellë në të vërtetën e humbjes . jo është periudha e vujatjes më të madhe dhimbjes akute mendore, ka shumë ndjenja dh mendime të rënda , tipike për preukupim i jashtëzakonshëm i imazhit të të ndjerit, ndërsa është rekomanduar se e njëjta ka nevojë të vazhdojë me konsulta

psikologjike edhe më tutje deri në zbehjen epo eliminimin e të gjitha simptomeve negative të shfaqura për jetën.

Për paditësen H., M., rezulton se e njëjta ka kaluar në fazën e goditjes shpirtërore dhe emocionale ku i ka shkaktuar hutim, tmerr, pasiguri në vetveten e saj, frikë humbje force, mpirje emocionale, pikëllim mungesë përkrahje etj, pastaj fazën e depresionit ( vuajtje, çorganizim, malli, vetmia, tërheqja në vetvete dhe zhytja e thellë në të vërtetën e humbjes . jo është periudha e vuajtjes më të madhe dhimbjes akute mendore, ka shumë ndjenja dh mendime të rënda , tipike për preokupim i jashtëzakonshëm i imazhit të të ndjerit, ndërsa është rekomanduar se e njëjta ka nevojë të vazhdojë me konsulta psikologjike edhe më tutje deri në zbehjen epo eliminimin e të gjitha simptomeve negative të shfaqura gjatë këtyre viteve.

Paditësi J., M., ka kaluar në fazën e goditjes shpirtërore dhe emocionale, duke ndjerë tmerr, pasiguri në vetvete, frikë, humbje force, mpirje emocionale, pikëllim, mungesë përkrahje, humbje gjumi, oreksi.

Ka kaluar në fazën e mohimit ku karakterizohet nga mosbesimi në realitetin e humbjes, personi bind vetën dhe të tjerët “ çdo gjë do të shojë mirë” se “ mjekët e ishin gabim” se “ai do të kthehet në shtëpi”.

Fazën e agresionit, duke qenë në këtë fazë të taimit me vdekjen njeriut më të dashur, personi mund të kërcënojë fajtorin ose anasjelltas, të përfshihet në vetëflagjelim duke u ndjerë fajtorë për atë ndodhi, që është karakterizuar tek personi me ndryshimet e gjumit frikë nga paniku, ndryshimet në oreks, peridha e të qarit e pashpjegueshme, ndryshime të papritura të humorit, mungesa e motivimit, rritja e nevojës për të folur për të ndjerin, dëshira e fortë për të qenë vetëm. Faza e depresionit ( vuajtje, çorganizim, malli, vetmia, tërheqja në vetvete dhe zhytja e thellë në të vërtetën e humbjes . jo është periudha e vuajtjes më të madhe dhimbjes akute mendore, ka shumë ndjenja dh mendime të rënda , tipike për preokupim i jashtëzakonshëm i imazhit të të ndjerit, ndërsa është rekomanduar se e njëjta ka nevojë të vazhdojë me konsulta psikologjike edhe më tutje deri në zbehjen epo eliminimin e të gjitha simptomeve negative të shfaqura gjatë këtyre viteve.

Paditësja A., M., ka kaluar nëpër fazën e goditjes shpirtërore dhe emocionale pas marrjes së lajmit njëher të aksidentit e pastaj të vdekjes së babait e përcjellur me mungesën, pikëllimin, frikën, gjumin, oreksion, mpirjen emocionale, fazën e mohimitku karakterizohet nga mosbesimi në realitetin e humbjeve, Faza e depresionit ( vuajtje, çorganizim, malli, vetmia, tërheqja në vetvete dhe zhytja e thellë në të vërtetën e humbjes . jo është periudha e vuajtjes më të madhe dhimbjes akute mendore, ka shumë ndjenja dh mendime të rënda, tipike për preokupim i jashtëzakonshëm i imazhit të të ndjerit, ndërsa është rekomanduar se e njëjta ka nevojë të vazhdojë me konsulta psikologjike edhe më tutje deri në zbehjen epo eliminimin e të gjitha simptomeve negative të shfaqura gjatë këtyre viteve.

Paditësi A., M., ka kaluar nëpër fazën e goditjes shpirtërore dhe emocionale pas marrjes së lajmit njëher të aksidentit e pastaj të vdekjes së babait e përcjellur me mungesën, pikëllimin, frikën, gjumin, oreksion, mpirjen emocionale, fazën e mohimitku karakterizohet nga mosbesimi në realitetin e humbjeve, Faza e çrregullimit të shkurtër periodik depresiv, ku është një formë e butë

dhe e lehtë e depresionit që mund të kompromentojë funksionimin, pek kryeshtë të rjhtë dhe karakterizohet me peridha të shkurtra humorit depresiv ose të përzier, që zkonisht zgjasin më pak se dy javë, është rekomanduar se e njëjti ka nevojë të vazhdojë me konsulta psikologjike edhe më tutje deri në zbehjen epo eliminimin e të gjitha simptomovae negative të shfaqura gjatë këtyre viteve.

Nga leximi i ekspertizës së komunikacionit, dhe dëgjimit të ekspertit të komunikacionit S., B., rezulton se Ngasësi i automjetit “ A” ( R., H.,” ka qenë shkaktar i aksidentit , me faktin që është kyqur nga rruga dytësore në rrugën kryesore duke i marrë përparësinë e kalimit automjetit “ B”, ngasësi “ A” nuk ka poseduar patentë shoferë dhe lidhur me faktin e mos posedimit të patentë shoferit ngasësi “ a” nuk i njuh rregullat e sigurisë në trafik, ndërsa ngasësi “ B” ka qenë duke lëvizur në rrugën kryesore konstatoj se nuk k kontribuar në shkaktimin e aksidentit por ka dhënë kontribut sekondrë në shpejtësinë e lëvizjes pra ka ndikuar në rritjen e vëllimit të dëmëve, ngasësi “ B” ka lëvizur me shpejtësi rreth 70 km/h në zonën e kufizuar me 50 km/h shpejtësi jo-adekuate sipas rregullave, shenjave dhe kushteve të krijuara në komunikacion.

## **Baza ligjore**

Në mbështetje të nenit 160.5 të LPK-së, baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësve, gjën mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së përcaktohet se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”*

Me nenin 140 të LMD-së përcaktohet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”*

Me nenin 159 përcaktohet se: *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë nëbazë të fajit.”*

Me nenin 177 të LMD-së përcaktohet se: *“Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t`i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij.”*, ndërsa me nein 178 par.1 dhe 2 të LMD-së përcaktohet se: *“1. Personi, të cilin e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht personi që i është shkaktuar vdekja si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga personi, të cilit i është shkaktuar vdekja ka të drejtë të shpërblimit të dëmit që pëson nga humbja e ushqimit ose e ndihmës. 2. Ky dëm shpërblehet me pagimin e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja po të mbetet gjallë.”*

Me nenin 184 të LMD-së përcaktohet se: *“Në rast vdekjeje të ndonjë personi, Gjykata mund t`ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore.”* Ndërsa me nenin 184.2 të LMD-së përcaktohet se: *“Ky shpërblim mund t`u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftësendërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme.”*

## **Të gjeturat e Gjykatës**

Për gjykatën nuk është kontestsuese se me datën 30.09.2015 në rrugën Z., P.,-Mitrovicë, në fshatin .., ka ndodhur aksidenti në mes vetuues V. i tipit S. me tara 02-..CB, e drejtuar nga R., H., dhe veturës R.,t e tipit C., tarha 02-..-Ar e drejtuar nga N.M.

Nuk është kontestsues as fakti se në këtë aksident ka pësuar lëndime të rënda trupore ngasësi “ B” i veturës N.M.

Nuk është kontestuese se N.M ka vdekur me datën 07.12.2015 si pasojë e aksidentit të ndodhur me datën 30.09.2015, fakt i vërtetuar nga fletvdekja me epikirizë me numër të amzës 341/15 lëshaur nga QKUK me 07.12.2015 dhe Vertetimi i vdekjes.

Nuk është kontestsuse se N.M para datës 30.09.2015 ka jetuar në bashkësi familjare me nënën Sh., M., bashkëshorten H., M., djemtë J., dhe A., M., dhe vajzën A., M., fakt i vërtetuar nga deklarata e bashkësisë familjare, me nr rendor 11/11001/1 lëshaur me daën 17.12.2015 nga Ministria e Punëve të Brendhsme.

Për gjykatën nuk ishte kontestues fakti se N.M fillimisht është trajtuar në Spitalin e Mitrovciës e pastaj në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, kjo vërtetohet nga dokumentacioni mjekësor i lshuar nga Spitali i Përgjithshëm Rajonal në Mitrovcië dhe QKUK.

Nuk është kontestsues as fakti se N., M., nga data 01.10.2015 deri me datën 15.10.2015 është trajtuar në Spitalin A.S në SHKUP, ky fakt është vërtetuar edhe nga leximi I konstatimit të doktorit .., pranë Spitalit A., S., dhënë me datë 15.10.2015, rezulton se N.M, është 15 ditë në ICU në Spitalin K., A.S.Shkup.

Nuk është kontestsues fakti se N., M., tri ka vdekur më 07.12.2015 në moshës 42 vjeçare, duke lënë pas nënën në moshën 65 vjecare, gruan në moshën 40 vjeçare, djalin Januzin në moshën 12 vjecare, vajzën Angjelinën në moshën 10 vjeçare, djalin A., M., në moshën 8 vjecare.

E paditura nuk e kundërshtoi bazën e kërkesëpadisë, por kundërshtoi larësinë e kërkesëpadisë duke amrrë parsysh përgjegjësinë sekondare të tani të ndjerit N.M në shkaktimine aksidentit.

Pra kontestuese në këtë çështje u paraqit përgjegjësia sekondare e tani t ndjerit N.M nga paditësit si dhe lartësia e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit nga ana e të padituriës.

Për gjykatën nuk qëndron pretendimi i të autorizuarëve të paditësve se tani i ndjeri N.M nuk ka pasur përgjegjëse për shkaktimin e aksidentit, të datës 30.09.2015, kjo pasi që Gjykata ia fali besimin ekspertizës së komunikacionit të punuar nga eksperti .., I cili në mendimin dhe kontaimin e tij ka thënë se përgjegjësi sekondare në aksidentin e datës 30.09.2015 ka ngasësi “ B” N.M pasi që i njejtë ka vizitur me shpejtësi prej 70 km/h në zonën në të cilën shpejtësia e

lejuar është 50 km/h, andaj me shpejtësinë e tejkaluar prej 20km/h I nejjti ka kontrubuar në mënyrë sekondare në aksidentin e shkaktuar.

Për gjykatën qëndron pretendim i të paditurës lidhur me lartësinë e kerkesëpadisë kjo duke u mbështetur edhe në Udhëzuesin për caktimin e kriterve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material të Gjykatës Supreme të datës numër 41/23 të datës 27.02.2023, i cili ka përcaktuar kriteret për caktimin e kompensimit të dëmit jo material për shkak të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e bashkëshortit është kompensimi 8000.00 deri në 15000.00 euro, për kompensimit të dëmit jo material për shkak të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e djalit është kompensimi 8000.00 deri në 15000.00 euro, për ekompensimin edëmit jo material për shkak të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e prindit është kompensimi 8000.00 deri në 12000.00 euro.

Gjykata vlerësojë se shuma e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në emër të kompensimit për dhimbjet shpirtërore për shkak të vdekjes së anëtarët e familjes ëshët në pëpruthje me ekspertizën psikatrike të Dr. , dhe psikologut Dr. , është në proporcion me të mirën e shkelur dhe me qëllimin e kompensimit për dëmin jo material.

Gjykata vlerësojë posaçërisht rrethanat si moshën e të ndjerit N.M, i cili ditën që ka dërruar jetë ka qenë 42 vjeçar, se i nejjti ishte i vetmi mbajtës i familjes, se pas vete ka lënë bashkëshorten të moshës 40 vjeçare, fëmijët djalin J., të moshës 12 vjeçare, vajzën A., të moshës 10vjeçare dhe fajin A., moshës 8 vjeçare si dhe nënën Sh., në moshën 60 vjeçare. Përveç dhimbjeve shpirtërore që ka shkaktuar aksidenti i datës 30.09.2015 gjykata ka vlerësuar se nga data 30.09.2015 kur i njderi ka pësuar lëndime të rënda trupore në aksident dhe deri me datën 07.12.2015 kanë kaluar 67 ditë sigurisht që tek paditësi janë përcjellur me intezitet të lartë të dhimbjeve. Megjithatë Gjykata rithekson se kompensimi i dëmi jo material në vetvete ka një qëllim e që është satisfaksioni për të dëmtuarin. Në këtë kontekst kjo gjykatë vlerëson se shpërblimi i dëmit në këtë rast është caktuar në kuptimin që të jetë i drejtë dhe adekuat me vëllimin e dëmit që kanë pësuar paditësit. Kjo nënkupton se lartësia e kompensimit jepet si satisfaksion dhe motivohet nga qëllimi që t'i mundësojë paditësit satisfaksion-kënaqje të caktuar për vlerën e dëmit jo material. Lartësia e kompensimit të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore është në përputhje të plotë me qëllimin e kompensimit që është satisfaksion moral, pastaj në përputhje me praktikën gjyqësore dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të datës 27.02.2023 për lartësinë e kompensimit të dëmit jo material dhe se në asnjë mënyrë shumat e gjykuara nuk paraqesin aspekt lukrativ e pasuruese por vetëm satisfaksion moral.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit në mbështetje të nenit 177 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se “ Kush shkaktonte vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t'i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij. 2. Ai ka për detyrë të shpërblejë edhe shpenzimet e mjekimit të tij nga lëndimet e marrura dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me mjekimin dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë”.

Gjykata paditëses së parë ia njohu të drejtën e kompensimit të dëmit material në emër të shpenzimeve mjeksore shumë prej 20,000 euro pasi që nga provat e administruara dhe atë nga fatura me numër 291278183/15, lëshuar me datë 17.10.2015, nga Klinika A.,S.,në gjuhën

angleze rezulton se trajtimi mjeksor për N.Mn I lindur më ., në valutën euro është 19.600 euro, fatura e Medical I., nr. 134263 datës 28.10.2015 vërtetohet fakti se për shpenzimet lidhur me gjendjen shëndetësore të N.M-t është paguar shumë në lartësi prej 150.00 euro, formulari i Kompanisë S.F.B rezulton se N.M nga QKUK në Prishtinë është dërguar në Klinikën A., S., në Shkup, përmes Kompanisë S.F.B., me datën 01.10.2015 në ora 03:05 nga transaksioni bankar në Procredit Bank vërtetohet fakti se kompanisë për bartjen e pacientit N.Mt në emër të transportit i janë paguar 350.00 euro, nga kuponi numër 0136700 i datës 16.11.2015 rezulton se janë shkaktuar shpenzime për barëra në shumë prej 20 euro, nga kuponi numër 0036957 i datës 17.11.2015 për shpenimet e barërave janë paguar 16.00 euro dhe nga kuponi numër 032609 rezulton se janë shkaktuar shpenzime në shumë prej 15 euro, ( 19.600+150+350+20+16+15=20,151.00 euro) por duke u mbështetur në nenin 2.1 të LPK-së i cili përcakton se “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse” gjykata lidhur me kompensimin e shpenzimeve mjeksore aprovoi kërkesën për shumën prej 20,000 euro si të bazuar pasi që kjo shumë është vërtetuar me provat e cekura si më lartë se për mjekimin e tani të ndjerit N.M paditëses se parë i është shkaktuar dëm material në shumë prej 20, 000euro.

Gjykata aprovoi vetëm pjesërisht kërkesën e paditëses së parë për kompensimin e dëmit material në emër të shpenzimeve të varrimit, në shumë prej 645.08 euro, për shkak se nga provat e administruara dhe atë faturës 117/15 të D.P.H “ .,” datës 08.12.2015, rezulton se janë paguar 67.00 euro për 70 copë ushqim, faturës 118/15 të D.P.H “ .,” datës 09.12.2015, rezulton se janë paguar 136.44 euro për 70 sasi ushqimi, faturës 119/15 të D.P.H “ .,” datës 10.12.2015, rezulton se janë paguar 136.86 euro për 80 sasi ushqimi, faturës 120/15 të D.P.H “ .,” datës 11.12.2015, rezulton se janë paguar 169.49 euro për 80 sasi ushqimi, faturës 121/15 të D.P.H “ ., datës 12.12.2015, rezulton se janë paguar 137.29 euro për 60 sasi ushqimi, për pesë ditë sa ka zgjatur procedura e varrimit për shpenzimet e ushqimit gjatë procedurës së varrimit në total  $67.00+136.44+136.86+167.49+137.29=645.08$ ).

Gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit pasi që ka vlerësuar se kërkesëpadia ishte shumë e lartë dhe në shpërputhje me natyrën e dëmeve që ju ishte bërë paditësive, e gjithashtu në shpërputhje edhe me qëllimin e kompensimit për dëmin jo material.

Gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit duke refuzuar shpenzimet e varrimit në shumën prej 2,352.92 euro dhe shpenzimet për rregullimin e varrit në shumë prej 1500 euro, pasi që paditësja e parë me asnjë provë nuk e ka vërtetuar pretendimin e saj se i janë shkaktuar shpenzime në këtë shumë për cermoninë e varrimit dhe ngritjes së përmendores e kjo në mbështetje të nenin 313.1 të LPK-së I cili përcakton se “ Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.” Andaj gjykata e refuzoi i të pabauzar këtë pjesë të kërkesëpadisë.

Gjykata ka vendosur si në pikën V të aktgjykimit duke refuzuar pjesërisht kërkesën e paditësve lidhur me kamatën si për nga lartësia e saj ashtu edhe për nga koha e rrjedhjes së kamatës sepse aksidenti si pasojë e të cilit N.M ka humbur jetën e më vdekjen e të cilit paditësve i është shkaktuar dhimbje shpirtërore ka ndodhur me datën 30.09.2015.



Gjykata Supreme e Kosovës në Mendimin Juridik të datës 01.12.2020, ka përcaktuar se për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve numër 04/L-077 datë 19.06.2012.

Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme në pjesën e dytë pikën e VI-të lidhur me shkallën/ lartësinë e kamatës për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë ndodhur pas datës 19.12.2012 ka përcaktuar se shkalla e kamatvonesës vjetore për të gjitha kërkesat do të caktohet në lartësi prej 8 % përveç kur përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë.

Ndërsa lidhur me afatin e rjedhejes së kamatës në pjesën e tretë pikën XIV të Mendimit juridik të Gjykatës është përcaktuar se “ pavarësisht se kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit material ( dëmi i zakonshëm apo fitim i humbur) kamata fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të kërkesës së kedorit për kompensim dhe në rast të mos parashtrimit të kërkesës nga ana e kreditorit për kompensim atëherë fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë.

Gjykata me kujdes shqyrtoi kërkesën e parashtruar me datën 18.11.2015 për kompensimin e dëmit material dhe jo material si dhe njoftimin e të paditurës së datës 19.05.2016 se Komisioni i shkallës së Parë për trajtimin e dëmit lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit material dhe jo material kishte vendosur që paditësit të kompensohen në tërësi në shumë prej 3572.00 eur ndërsa për përfaqësim në shumë prej 215.00 euro në shumë totale prej 35935.00 euro. Andaj gjykata lidhur me afatin e rrjedhjes së kamatës llogariti datën 18.11.2015 kur paditësit kanë parashtruar kërkesën tek e paditura e cila me njoftimin e datës 19.05.2016 kishte shqyrtur kërkesën për kompensimin e dëmit.

Ndërsa në pikën XV të Mendimit juridik të Gjykatës Supreme lidhur me afatin e rrjedhës së kamatës për kompensimin e dëmit jo material është përcaktuar se “ pavarësisht se kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit jo material kamata fillon të rrjedhë nga data e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë e deri në pagesën definitive”, mbështetu në këtë pikë, gjykata vendosi që kamata për kompensimin e dëmit jo material të rrjedhë nga data 23.08.2024 datë e marrjes së aktgjykimit.

Gjykata vendosi si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit në mbështetje të nenit 452.5 të LPK-së i cili përcakton se “Kur kërkesëpadia ka të bëjë me të holla, e palën paditëse e përfaqëson avokati apo përfaqësuesi ligjor të cilit me ligj të posaçëm i njihet e drejta që t’i shpërblehen shpenzimet, atëherë shpenzimet për përfaqësim do të caktohen sipas lartësisë së kërkesës në të holla që është pranuar me aktgjykim.” Pasi që gjykata në pikën e I të dispozitivit vendosi që në emër të kompensimit të dëmit jo material paditësit të kompensohen në shumë prej ( 12,000+12,000+9,600+9,600+9,600 euro= 52,800 euro) ndërsa në emër të kompensimit për dëmin jo material në shumën prej ( 20,000+645.08=20,645.08 euro) sipas tarifës së Odës së Avokatëve, në kontestet me vlerë prej 10,000 euro e më lartë është paraparë që për përpilimin e padisë për pesë paditës t’i njihet shuma prej 624 euro, për përfaqësim në seancë për pesë paditës shuma prej 811.20 x 3 seanca = 2,433.6 euro), për seancën e datës 02.06.2022 shumën 202.8 euro 25% të 811.20 euro ( 81.20-25%= 202.8 euro) për taksë gjyqësore 500 euro, për ekspertizë të komunikacionit 150 euro, për ekspertizën e psikiatrisë shumën prej 150 euro, për ekspertizën psikologjike shumën prej 200 euro ( 150+150+200= 500 euro), në shumë totale 4,260.4 euro.

Gjykata vendosi si në pikën VI të dispozitivit të aktgjykimit pasi që kërkesa e paditësve që për shpenzimet e ekspertizave të kërkohet shuma prej 800 euro pjesërisht si e pabazuar sepse ekspertiza e komunikacionit ishte 150 euro, ekspertiza psikiatrike 150 euro ndërsa ekspertiza psikologjike ishte 200 euro në total 500 euro, andaj edhe e refuzoi në shumë prej 300 euro.

Nga të cekurat si më lartë e në mbështetje të nenit 143 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELOE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.447/16 dt 23.08.2024**

**G j y q t a r j a**

---

**Erolinda Uka-Sadiu**

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej pesëmbëshjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit Gjyatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj gjyakte në kopje të mjaftueshme për palët dhe gykatën.